

SOCIOLOGJI E SHQIPES ME HISTORI TË
STANDARDIZIMIT¹
SYLLABUSI 2013/2014

Universiteti i Prishtinës

Fakulteti i Filologjisë/ Departamenti i Gjuhës Shqipe

Niveli dhe lloji i kursit: (Bachelor/obligative)

Viti i studimeve dhe semestri: Viti II- Semestri III

Numri i orëve në javë: 2+1

Kodi ose shifra e lëndës:

Vlera në kredi ECTS : 6

Mësimdhënësi i kursit:

Prof. ass. dr. Shkumbin Munishi

Detajet kontaktuese:

Zyra 60

Tel: 044 124 290

Email: shmunishi@hotmail.com

Qëllimet e kursit (modulit):

Qëllimi kryesor i këtij kursi është që studentët të njihen me format e studimeve gjuhësore në raport me bashkësitë shoqërore. Është me rëndësi që studentët të kuptojnë ndikimin e faktorëve shoqërore në ligjërim dhe të jenë në dijeni për varietetet e ndryshme gjuhësore që ekzistojnë në kuadër të një bashkësie shoqërore dhe në këtë kuptim të njihen edhe me variacionin gjuhësor të gjuhës shqipe. Duke u bazuar në studimet e ndryshme sociolinguistike të nxjerra nga përdorimi i gjuhës, ky kurs fokusohet në atë se si gjuha konstrukton dhe i reflekton strukturat e ndryshme shoqërore dhe ndikimin e tyre në gjuhë, si dhe rolin e faktorëve shoqëror në përcaktimin e formës së ndërkomunikimit njerëzor.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studentët do të jenë në gjendje që:

1. T'i njohin konceptet themelore nga fusha e sociolinguistikës dhe të njihen me problemet themelore të sociologjisë së gjuhës shqipe

¹ Termat sociologji e gjuhës dhe sociolinguistikë përdoren si sinonime.

2. Të jenë në gjendje ta kuptojnë se si funksionon gjuha dhe të folurit në kuadër të bashkësive shoqërore dhe të bashkësive folëse dhe ta kuptojnë rëndësinë e gjuhës në ndërveprimin shoqëror, si dhe të kuptojnë se si është e shtresuar dhe si funksionon gjuha shqipe në kuadër të bashkësisë shqiptare.

3. T'i njohin implikimet e çështjeve gjuhësore në çështje të tjera shoqërore, politike e kulturore.

4. T'i njohin varietetet e ndryshme të gjuhës shqipe, krahas gjuhës standarde, dhe ta njohin historinë e procesit të standardizimit të shqipes

5. T'i njohin metodat e studimeve sociolinguistike të ligjërimit dhe të jenë në gjendje të bëjnë hulumtime të kufizuara të natyrës sociolinguistike

Metodologjia e mësimdhënies:

Ligjëratë, diskutim, seminare/ese.

Literatura bazë:

Richard A. Hudson, Sociolinguistika, Dituria, Tiranë, 2002.

Rexhep Ismajli, “Në gjuhë” dhe “për gjuhë”, Dukagjini, Pejë, 1998.

Rexhep Ismajli, Standarde dhe identitete, Dukagjini, Pejë, 2003.

Fadil Raka, Historia e gjuhës letrare shqipe, Tetovë, 1997.

Plani i detajuar i mësimi:

Java e parë: Çka është sociolinguistika; sociolinguistika dhe gjuhësia; zhvillimi sociolinguistik i fëmijës (Literatura: Hudson, 2002, f. 11-30).

Java e dytë: Gjuha dhe shoqëria; bashkësitë shoqërore, bashkësitë gjuhësore dhe bashkësitë komunikuese, njësitë gjuhësore dhe ndërlidhja e tyre shoqërore (Literatura: Hudson, 2002, f. 30-34).

Java e tretë: Varietet gjuhësore – gjuhët, dialektet, sociolektet dhe regjistrat. (Literatura: Hudson, 2002, f. 34-57).

Java e katërt: Gjuhës standarde dhe formimi i tyre; standardizimi i gjuhëve ballkanike (Literatura: Hudson, 2002, f. 43-45; Ismajli, 2003, f. 193 - 290).

Java e pestë: Varietetet gjuhësore të shqipes; histori e shkurtër e standardizimit të shqipes – nga Mesjeta deri në Pavarësia 1912 (Ismajli, 2003, f. 17 – 75; Raka, 1997, f. 65-179)

Java e gjashtë: Standardizimi i gjuhës shqipe- nga Komisia Letrare e Shkodrës deri ne Kongresin e Drejtshkrimit 1972, përpjekjet për standardizimin e shqipes në Kosovë (Ismajli, 1998, f. 35 – 208; Raka, 1997, f. 117 – 128)

Vlerësimi i parë intermediar

Java e shtatë: Kontaktet gjuhësore, ndërrimi i kodit dhe ndryshimi i stilit, diglosia dhe bilinguizmi, gjuhët pishinë dhe kreole (Literatura: Hudson, 2002, f. 60 – 75)

Java e tetë: Gjuha, kultura dhe mendimi (Literatura: Hudson, 2002, f. 82-119)

Java e nëntë: Të folurit si bashkëveprim shoqëror, (Literatura: Hudson, 2002, f. 121-158)

Java e dhjetë: Studimi sasior i ligjërimit dhe metodologjia studimore në sociolinguistikë (Literatura: Hudson, 2002, f. 162-224)

Java e njëmbëdhjetë: Shembuj të studimeve sasiore të ligjërimit (Literatura: Hudson, 2002, f. 174- 186)

Vlerësimi i dytë intermediar

Java e dymbëdhjetë: Pabarazia gjuhësore dhe pabarazia shoqërore (Literatura: Hudson, 2002, f.. 226 – 248)

Java e trembëdhjetë: Roli i faktorëve shoqëror në përshtatjen e të folurit, Përshtatja gjuhësore dhe Audience Design (Literatura: Hudson, 2002, f. 222-256)

Java e katërbëdhjetë: Gjuha dhe gjinia, dallimet gjuhësore midis meshkujve dhe femrave (Literatura: Hudson, 2002, f. 158 – 162)

Java e pesëmbëdhjetë: Sintezë e problemeve të diskutuara dhe ripërmbledhje e lëndës.

Vlerësimi përfundimtar

Metodat e vlerësimit:

Vlerësimi gjysmësemestral: 35%

Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera: 10%

Vijimi i rregullt: 5%

Provimi final: 50%

Totali: 100%

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët duhet t'i ndjekin me rregull ligjëratat. Në rast të mungesave të shumta të paarsyeshme studentëve nuk do t'u verifikohet pjesëmarrja e rregullt në ligjëratat e ushtrime. Prania e studentëve në ligjëratat dhe në ushtrime shënohet në fletat e evidencës. Studentët janë të obliguar të kenë sjellje të mirë dhe të mbajnë qetësi, si dhe t'i shkyçin telefonat mobilë gjatë ligjëratave.

Literatura shtesë dhe bibliografia:

1. Shkumbin Munishi, Gjuha standarde shqipe në Kosovë dhe drejtimet e zhvillimit të saj, disertacion i doktoratës, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2006.
2. Shkumbin Munishi, Pikëpamjet e Androkli Kostallarit për gjuhën standarde shqipe, punim i magistraturës, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2001.
3. Trudgill Peter, Sociolinguistics – An Introduction to language and Society, Fourth Edition, First Published in Pelican Books 1974, Penguin Books, 2000.
4. Byron, Janet. Selections Among Alternates in Language Standardization – The Case of Albanian, Mouton The Hague, Paris, 1976.
5. Sociolinguistics – a Reader, Edited by Nikolas Coupland and Adam Jaworski, St. Martin's Press, New York, 1997.